

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

FTOJ

Mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më 17.05.2022 (e martë) duke filluar në orën 11:00.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raportim dhe Diskutim rreth gjendjes në ambulantat e Komunës;
3. Diskutim rreth procedurave për fillim të hartimit të buxhetit të vitit 2023;
4. Njoftim nga zyra për Komunitete dhe Kthim rreth aktiviteteve të fundit;
5. Të ndryshme;

Me: 12.05.2022
Në: Novobërdë



Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit për Komunitete

Sh. Mustafa



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo – Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete e mbajtur me: 14.04.2022, duke filluar nga ora 13:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për Komunitete Shqipe Mustafa, antarët e komitetit: Dobrivoje Đorđević, Violeta Milošević, Vlora Vllasaliu, Igor Vasić, Edison Jashari, Selatin Nuhiu, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, zv.kryesuesi Ramush Mehmeti dhe përfaqësuesi i OSCE-a.

Kryesuesja e Komitetit Shqipe Mustafa pasi pershendeti të pranishmit konstattoj korumin, prezent janë 7 antarë të komitetit për komunitete dhe filloj mbledhjen me këtë:

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Aprovimi i orarit të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete;
3. Diskutim dhe aprovim i planit të punës së Komitetit për komunitete;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime njëzëri u aprovua rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë: Aprovimi i orarit të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete;

Kryesuesja tha: po besoj se të gjithë e keni marrë materialin me kohë e keni shqyrtuar, kam planifikuar që orari për mbajtje të mbledhjeve të komitetit për komunitete të mbahet para kuvendit dhe KPF-së, në mënyrë që nese keni ndonjë propozim ta dergojm në Kuvend, orari është vetem propozim nese keni ju ndonjë sugjerim ne mundë ta ndryshojm.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: orari që e paske dergu është në rregull, por në muajin maj është në ora 13:00, kishte qenë mirë që çdo herë të mbahet prej ores 10:00.

Kryesuesja tha: meqenëse unë jam në punë dhe vetem edhe një muaj do të punoj e kam caktuar orarin prej ores 13:00, ndërsa muajve tjerë do ti mbajm prej ores 10:00.

Selatin Nuhiu tha: ne të gjithë jemi duke punuar, ty ta lejon ligji mu liru prej punës për mbledhje.

Kryesuesja tha: në rregull do ti shikojm mundësit.

Dobrivoje Djordjevic tha: ndoshta nuk është problem te ora por datat, ne duhet të kemi hapsiren prej 7 ditëve ta mbajm para KPF-së.

Kryesuesja tha: kur kam pregaditur orarin e mbajtjes së mbledhjeve e kam shikuar edhe orarin e KPF-së dhe Kuvendit.

Pasi nuk pati propozime tjera aprovohet njëzëri orari për mbajtje të mbledhjeve me propozimin e Selatinit.

Pika e tretë: Diskutim dhe aprovim i planit të punës së Komitetit për komunitete;

Kryesuesja tha: jam bazuar në planin e punës të vitit të kaluar dhe kam bërë një plan përafersisht të ngjashëm, në mënyrë që të propozoni edhe ju aktivitete dhe pikat e juaja për planin e punës. Po besoj që ju të gjithë e keni marrë materialin por ne pika të shkurtra po e prezantoj: unë kam plaifikuar që të organizoj një takim me Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesen e Kuvendit në mënyrë që të na përkrahin në vazhdimësi, gjithashtu çdo muaj do të kemi raport nga drejtoritë, çdo muaj do të vij zyrya për kthim që ti raportoj aktivitete mujore, gjithashtu në hartimin e buxhetit kam parapa që ti kemi propozimet tona për projekte, këto janë disa pika më të rëndësishme që i kam parapa në planin e punës, nese keni propozime e hapi diskutimin.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: planin e punës së Kuvendit ashtu siç e tha edhe Kryesuesja e ka hartu duke u bazuar në planin e punës të vitit të kaluar, ashtu sikur orari edhe plani i punës duhet të jetë fleksibil, në ndërkohë varësisht prej situatave që mund të paraqiten mund të shtohen edhe propozime shtesë. Ajo që është me rëndësi ne katër mekanizmat kryesor që jemi: nënkryetari për komunitete, zv.kryesuesi për komunitete, kryesuesja e komitetit për komunitete dhe shefja e ZKKK të kenë takime të rregullta dhe të diskutojnë për qështjet që kanë të bëjnë me komunitetet dhe ta ndihmojm kryesuesen e komitetit për hartimin e rendit të ditës dhe pikat e rendit të ditës që parashihet të mbahen. Pra Kryesuesja në këtë planë të punës i ceki ato pika që i ka parapa se do të zhvillohen por ndërkohë edhe ju do të ndihmoni dhe kontriboni në këtë drejtim për mbledhjet që do të pasojnë.

Dobrivoje Djordjevic tha: në përbërjen e kaluar fatkeqësisht ky komitet ka qenë vetem formal, prandaj e lus Kryesuesen e komitetit nese keni ndonjë kërkesë prej qytetarëve edhe pas mbajtjes së kësaj mbledhje të keni të drejtë ju ta prezantoni atë pikë në Kuvend.

Kryesuesja tha: për këtë arsye e kam bërë planin e punës dhe sigurisht se do të jem pergjegjëse në punën time dhe ju e keni nr. e telit dhe e-mail dhe sa herë do të keni ndonjë propozim ndonjë pikë mund të më shkruani sepse komunikimi ynë sigurisht që e bënë punën më të fortë dhe të dobishme.

Selatin Nuhiu tha: ne e kemi planin e punës që e keni parapa ju është gjithpërfshirës dhe ne si antarë kemi të drejt për propozime shtesë nese paraqitet ndonjë kërkesë prej qytetarëve.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri plani i punës së Komitetit për Komunitete.

Pika e katërt: të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: kërkoj nga asistentja e Kuvendit së paku nga një shishe ujë ta kemi në mbledhje, kërkoj nga ju si kryesuese ta shfrytëzoni OSBE-n për projekte të ndryshme në organizata të ndryshme.


Kryesuesja tha: unë pajtohem me fjalët tuaja dhe sigurishte se bashkpunimi nuk është nese njëri punon, por bashkpunim duhet të kemi të gjithë.

Pasi nuk pati diskutime tjera kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në 13:30h.

Valmire Mustafa

Procesmbajttese



Shqipe Mustafa

Kryesuese e Komitetit për Komunitete

